



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

**MINISTRIA E BRENDSHME  
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA**

Nr. 2089 prot.

Tiranë, me 15.10. 2020

**Lënda:** Njoftim

**Drejtar:** Autoritetet kontraktore zbatues të VKM 82/2018, i ndryshuar.

**Për dijeni:** Agjencisë së Prokurimit Publik

Tiranë

*Të nderuar,*

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 82, datë 14.02.2018 “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrisë, ministrike dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, i ndryshuar, organi qendror blerës Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (këtu e në vijim “ABP”), njofton të gjitha autoritetet kontraktore zbatuese të këtij vendimi, si vijon:

- I. Me qëllim zhvillimin dhe realizimin në kohë të procedurave të prokurimit nga ABP, për plotësimin e nevojave të autoritetet kontraktore për vitin 2021 e në vijim, për objektet e prokurimit të përqendruara dhe të qendërzuara, që zhvillohen nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, njoftojmë autoritetet kontraktore se duhet të dërgojnë kërkesat e tyre në ABP sa më shpejt, por **jo më vonë se data 23 Tetor 2020.**
- 1) Autoritetet kontraktore duhet të dërgojnë pranë ABP-së, të dhënrat teknike, sasiore dhe fondin përkatës për mallrat e shërbimet që do të prokurohen **nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër**, për secilin nga objektet e prokurimit:
  - 1.1 Blerje karburanti, përveç vajgurit Jet A1;
  - 1.2 Blerje materiale kancelarie;
  - 1.3 Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash;
  - 1.4 Blerje materiale të ndryshme për pastrim;
  - 1.5 Blerje uniforma dhe elemente të tjera përbërëse të tyre;
  - 1.6 Blerje këpucë;
  - 1.7 Blerje pjesë këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike;
  - 1.8 Blerje tonera;
  - 1.9 Blerje artikuj ushqimore;
  - 1.10 Blerje materiale të buta dhe veshimbathje;
  - 1.11 Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi, me përjashtim të shtypshkrimeve dhe të letrave me vlerë që prokurohen sipas legjislacionit në fuqi;
  - 1.12 Sigurim automjetesh;
  - 1.13 Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi;
  - 1.14 Shërbim pastrimi;

- 1.15 Shërbim gjelbërimi;  
1.16 Shërbim dezinfektimi;  
1.17 Shërbim lyerje dhe mirëmbajtje ndërtesash;  
1.18 Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh;  
1.19 Riparim, mirëmbajtje sistemi të ngrohje-ftohjeve;  
1.20 Mirëmbajtje impiante elektrike.
- 2) Autoritetet kontraktore, për çdo objekt prokurimi duhet të dërgojnë **kërkësë të veçantë**, me shkrim dhe në format elektronik (me CD dhe në e-mail: *ZhvillimiProkurimeve.ABP@mb.gov.al*), ku të përcaktohen: objekti i prokurimit, afati dhe fondi i marrëveshjes kuadër (Lekë pa TVSH). Kërkesa e veçantë për secilin objekt prokurimi, të shoqërohet me dokumentacionin e të dhënët e plota, si vijon:
- a) Parashikimi i afatit dhe përllogaritja e argumentuar e fondit të marrëveshjes kuadër (Lekë pa TVSH). Sqarojmë se, autoritetet kontraktore duhet të dërgojnë kërkësat për prokurim nëpërmjet marrëveshjes kuadër **me afat të paktën 2 (dy) vjet**, dhe në çdo rast, foni i marrëveshjes kuadër që do të dërgohet në organin qëndror blerës, duhet t'i referohet Planifikimit Buxhetor Afatmesëm (PBA) të autoritetit kontraktor;
  - b) Sasitë e pritshme dhe çmimi / njësi (Lekë pa TVSH). Sqarojmë se, të dhënët sasiore të pritshme për objektet e prokurimit me specifikime teknike të unifikuara dhe çmime për njësi (të rishikuara) nga ABP, duhet të plotësohen sipas dokumentit përkatës “*Excel*” (bashkëngjitur këtij njoftimi).
  - c) Specifikimet teknike dhe/ose termat e referencës, të hartuara nga të paktën 1 (një) specialist fushe, për mallrat dhe shërbimet të cilat nuk kanë specifikime teknike/ termë reference të unifikuara;
  - ç) Në rast të dërgimit të kritereve të veçanta të pranimit lidhur me kapacitetin teknik që duhet të plotësojnë operatorët ekonomik, për objekte specifike prokurimi, autoritetet kontraktore të përfshijnë specialistë fushe gjatë hartimit dhe të mirëargumentojnë, teknikisht dhe ligjërisht, vendosjen e çdo kriteri nga ana e tyre;
  - d) Grafiku i lëvrimit të mallrave dhe/ose zbatimit të shërbimeve;
  - dh) Për objektin e prokurimit “*Blerje karburanti, perveç vajgurit Jet A1*”, të specifikohet nëse lëvrimi do të kryhet me kartë elektronike ose autobot;
  - e) Të dhënët e kontaktit për personin / personat përgjegjës për prokurimin në autoritetin kontraktor (emër mbiemër, numër telefoni, adresë e-mail).
  - ë) Informacion në lidhje me afatin e pritshëm të përfundimit të marrëveshjes kuadër që kanë në fuqi.
- 3) ABP ka unifikuar specifikimet teknike dhe çmimet për njësi (të rishikuara), për objektet e mëposhtme të prokurimit:

- 3.1 Blerje tonera;
- 3.2 Blerje materiale kancelarie;
- 3.3 Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash;
- 3.4 Blerje karburant, perveç vajgurit *Jet A1*;
- 3.5 Blerje pjesë këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike (e ndarë në 3 Lote);
- 3.6 Sigurim automjete (e ndarë në 2 Lote);
- 3.7 Blerje artikuj ushqimorë (e ndarë në 7 Lote);
- 3.8 Blerje materiale të buta dhe veshimbathje (e ndarë në 3 Lote);
- 3.9 Blerje uniforma dhe elemente të tjera përbërëse të tyre - Uniforma për personel mjekësor;
- 3.10 Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh (specifikimet teknike/ termat e references të unifikuara);
- 3.11 Shërbim dezinfektimi (e ndarë në 2 Lote).
- 3.12 Blerje materiale të ndryshme për pastrim (e ndarë në 3 Lote, përfshirë artikujt kundër COVID-19).

Bashkëngjitur këtij njoftimi, dërgohen specifikimet teknike të unifikuara dhe çmimet për njësi (të rishikuara) nga organi qendror blerës, në format elektronik CD.

Në rast të dërgimit të kërkesës për prokurim, nga institucionet eprore edhe për institucionet e tyre të varësissë, duhet të saktësohen nevojat sasiore për secilin institucion varësie që ka fondej për lidhjen e kontratës, si dhe vendi ku do të dorëzohen mallrat apo kryhen shërbimet.

ABP do të informojë Agjencinë e Prokurimit Publik në çdo rast kur konstaton mosrespektimin e afateve kohore të përcaktuara në këtë njoftim.

*Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,*

**TITULLAR I ORGANIT QENDROR BLERËS**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Edlira NAQELLARI**

